



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 741/2 Prot

Rrëshen më, 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 47 datë 19. 06. 2025

P Ë R

“MIRATIMIN E HAPJES TË RRUGËS SË RE AUTOMOBILISTIKE QË LIDH FSHATIN LAJTHIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE OROSH, 4608, BASHKIA MIRDITË ME FSHATIN VLASHAJ TË NJËSISË ADMINISTRATIVE LURË, BASHKIA DIBËR”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, neni 6, gërma “i”, të VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar me VKM nr. 686, datë 22. 11. 2017, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, VKM nr. 684, datë 02. 09. 2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08. 06. 2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar, Urdhërit nr. 44, datë 14. 02. 2025, i Kryetarit të Bashkisë, “Për hartimin e raportit nr. 741 datë 18. 02. 2025, mbi studimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore në administrim të Bashkisë Mirditë”, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 17. 06. 2025, të Komisionit të Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës, për t’ia kaluar në seancë Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes të rrugës së re automobilistike, që lidh fshatin Lajthizë, njësia administrative Orosh, 4608, Bashkia Mirditë me fshatin Vlashaj të njësisë administrative Lurë, Bashkia Dibër
 - Segmenti i rrugës ka një gjatësi L = 960.00 ml, gjërësi kaluese 5. 00 ml, shtrihet në fond pyjor/kullosor publik, në nëngastrat pyjore nr. 27b, Ekonomia pyjore/kullosore (pjesë ekonomike) Lajthizë, në administrim/pronësi të bashkisë Mirditë dhe në pasuritë me nr.pas 277, Zona Kadastrale 2368
2. Plani i vendosjes së gjurmës së rrugës Sh. 1: 5,000, planimetria Sh. 1: 5,000, Raporti nr. 741 prot, datë 18. 02. 2025, “Mbi studimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes për fondin pyjor/kullosor pjesë përbërse këtij vendimi

3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë
5. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Orosh)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 741/1 Prot

Rrëshen më, 18 . 02 . 2025

P/VENDIM

Nr. 22 , 18.02 2025

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS SË RE AUTOMOBILISTIKE QË LIDH FSHATIN LAJTHIZË NJ.ADM. OROSH, 4608”, BASHKIA MIRDITË ME FSHATIN VLASHAJ, BASHKIA DIBËR.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, dhe projekt – vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, kërkesës nr. 4222 prot, datë 06.11.2024 të banorëve Aleksandër Lleshi, Lek Skana dhe Frok Margjini , të Fshatit Lajthizë , Orosh.

V E N D O S I:

- 1.Miratimin e hapjes së rrugës, të re automobilistike, që lidh fshatin Lajthizë nj.adm. Orosh,4608”,bashkia Mirditë me fshatin Vlashaj,Bashkia Dibër
- 2.Segmenti i rrugës ka një gjatësi L= 960.00 mL, gjërësi kaluese 5. 00 mL, dhe shtrihet në pasuritë me nr. pas 277, Zona Kadastrale 2368.
- 3.Plani i vendosjes së gjurmës së rrugës Sh. 1: 5,000, planimetria Sh. 1: 5,000, Raporti nr. 741, prot, datë 18.02.2025, studimin tekniko-ekonomik për fondin pyjor, dhe VKM 684 datë 02.09.2020 Për transferimin e pyjeve në pronësi të bashkisë.
- 4.Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.
- 5.Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.

6.Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Orosh).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI
Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksandër PICAKU

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit te Territorit; Ing. Ark. Julian TUSHA

Drejtoria Juridike; B. DEDAJ



KRYETARI

Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 741 Prot.

Rrëshen, më 18.02.2025

R A P O R T

MBI STUDIMIN TEKNIKO – EKONOMIK TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË MIRDITË, NJËSIA ADMINISTRATIVE OROSH

*(Ndërtim rruge auto, me gjatësi rreth 1 km, kryesisht përgjatë rrugës kembësore që lidh fshatin
Lajthizë bashkia Mirditë me fshatin Vlashaj bashkia Dibër.)*

Në zbatim të Urdhërit nr.44, datë 14.02.2025 të Kryetarit të Bashkisë për hartimin e Raportit të studimit tekniko – ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore që përshkon gjurma e projektuar për ndërtimin e një segmenti rruge auto pyjore, me gjatësi rreth 1 km, që lidh fshatin Lajthizë, njësi administrative Orosh, bashkia Mirditë, me fshatin Vlashaj, njësi administrative Lurë, bashkia Dibër; Grupi i punës i përbërë nga; Gjovalin Nikolli, Preng Nikolli dhe Eneida Nikolli, Sektori i Monitorimit dhe Sherbimit Pyjor në bashki, pasi u njoh me Urdhërin e Kryetarit të bashkisë, dhe administroj dokumentacionin teknik të gjurmës së rrugës, realizoi verifikimin e gjurmës në terren, dhe referuar të dhënave në regjistrin kadastral të pyjeve/kullotave bashkiake, u konkludua si më poshtë.

Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës, në kufijt administrative të bashkisë Mirditë, fshati Lajthizë, është rreth 0.48 ha, me gjatësi rreth 960 ml (1 km) dhe gjerësi mesatare rreth 5 m, fond pyjor/kullosor publik, në n/nëngastra pyjore nr 27 b, Ekonomia Pyjore/Kullosore (pjesë ekonomike) Lajthizë, në administrim/pronësi të, bashkisë Mirditë, Njësia administrative Orosh.

Nga përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi (ku kalon gjurma e rrugës auto për ndërtim), formularët 1 dh 2 bashkëngjitur, rezulton tokë me bimësi pyjore, me një shkallë mbulimi deri në 30%, ku evidentohen, ekzemplarë të rrallë të llojit pishë e zezë, dëllinjë e kuqe, trandafil i egër, grathatel, etj.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin Teknik dhe të verifikuara në terren, nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesor të sipërfaqes pyjore/kullosore bashkiake.

Ndërtimi dhe vënja në funksion i këtij segmenti rruge auto, i shërben mjaftueshëm jo vetëm nevojave të përditëshme të komunitetit të kësaj zone, por rëndësi të veçantë merr kjo rrugë, në rastet e emergjencave civile, ndërhyrjet efikase të shërbimit zjarrfikës në raste zjarri në pyje, si dhe në rritjen e efikasitetit të strukturave të shërbimit civil në përgjithësi, dhe të strukturave ligjëzbatuese në monitorimin dhe kontrollin e teritorit në veçanti.

Nga matjet dhe vlerësimet e kryera lidhur me pakësimet në volum të materialit drusor nga ndërtimi i kësaj rruge, nuk rezulton të kemi material drusor të vlerësueshëm (të dhënave të përshkruara në formularin nr.4, bashkëngjitur)

Ky akt mbahet në katër kopje dhe është pjesë e dokumentacionit teknik të administruar në D.P.ZH.T në Bashki.

PËRPILUESIT E KËTIJË RAPORTI

Ing.Gjovalin Nikolli



Ing.Eneida Nikolli



Ing. Preng Nikolli



DREJTORI

Kasrtiot BICA



K O N F I R M O I

KRYETARI

Albert MËLYSHI



A : ESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

BASHKIA MIRDITË

PASQYRA E PËRSHKRIMIT PARCELAR (sipas rregjistrit kadastral, inventarit të transferimit dhe verifikimeve në terren)
(Nderitim rruge auto në Fshatin Lajthizë, njësia administrative Orosh)

Formulari 1

ID.i Pronës	Ekonomia pyjore/kullosore	Parcela nr.	Përbërja e grumbullit	Funksioni	Forma e qeverisjes	Të dhëna të grumbullit pyjor						Fuqia lendore në këmbë m3	
						Kl.Mosh ës	K.D	D mes	H mes	Filizeria	n/pylli	Katet	Total
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
LE 21 027/b	Pj.Ek.lajthizë	27/b	Bimesi pyjore	mbrojtës	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali													0

TABELA E PERSHKRIMIT TE SIPERFAQES KULLUSORE

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NË PËRDORIM
(Pë ndërtim rruge auto në Fshatin Lajthizë, njësia administrative Orosh)

Formulari 2

ID I Pronës	Ekonomia pyjore/kullosore	Parcela nr.	Bimesia në % Leguminace, graminace etj	Sip.sipas tipit të kullotes në ha		Ngarkesa në krere që kulloshin						Vlera e kullotes në 000/lekë	
				Dimerore	Verore	Total	Dhen	Dhi	Dhen	Dhi	Të trasha	Total	Total
1	2	3	4	5	6	7	8	9	-	-	10	11	12
0	0	0	0	0	0	0	0	0	-	-	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	-	-	0	0	0



LISTA E NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NË PËRDORIM
(Për ndërtim rruge auto në Fshatin Lajthizë, njësi administrative Orosh)

ID i Pronës	Përdorimi	Ekonomia pyjore/kul- losores	n/Parcela nr.	Sip.totale	Sipërfaqe me punime	Viti i kryerjes së punimeve	Punimi i kryer ne ha/m3	Vlera e invest. në 000 lekë		
							Pyllëzim përmiros	Sist.mal		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
LE21 027 b	Bimesi	Pj.Ek.Lajt hizhë	27 b	10.32	0	0	0	0	0	0
	Totali		0	10.32	0	0	0	0	0	0

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDISË PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NË PËRDORIM
(Për ndërtim rruge auto në Fshatin Lajthizë, njësia administrative Orosh)

[illegible]

